

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Nr. 08-2973/2

26.11.2024

K e r ç o v ë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 42-të e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 26.11.2024 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10:00.

Seancën në ora 10:00 e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Kamerr Klosi, Drenuse Dalipi, Filip Mitreski, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Olgica Poposka, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Valentina L Lazaroska, Bojan Stojkoski, Ivanço Bozhinoski, Viktor Aleksoski, Sibel Tufkegji, Abdulla Sejdini, Fortesa Sejdini, Ramazan Zulbeari, Migjen Zendeli dhe Nexhbi Dervishi.

Në mungesë ishte këshilltarja: Valbona Adili Emini

Në seancë të pranishëm ishin edhe Aneta Nasteska – Sekretare e Komunës, Valdet Selimi, Burim Kadriu, Bujar Veseli - përfaqësues nga administrata komunale, përfaqësues nga NK „Komunalec,, dhe drejtori i Universitetit të punës „Krste Misirkov,,

Kryetari i këshillit përshëndeti të pranishmit dhe përgëzoi këshilltarin Nexhbi për fitimin e pesë vendeve të para nga klubi i tij dhe i uroi suksese të vazhdueshme.

Më pas, Kryetari i Këshillit vendosi për miratim procesverbalin e seancës së 41-të të Këshillit të Komunës së Kërçovës të mbajtur më 29.10.2024 dhe u miratua unanimitisht me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit bën me dije se për këtë seancë ka plotësuar të rendit të ditës me një pikë shtesë, e cila ka të bëjë me programet zhvillimore dhe do të jetë pika e tretë e rendit të ditës, dhe atë: "Propozim Plan Zhvillimor për Programin për Zhvillimin e rrugëve lokale dhe rrugicave", dhe pika e tretë nga rendi i ditës që iu është dorëzuar do të jetë e katërta, e katërta e pesta e kështu me radhë.

Kryetari i këshillit për këtë seancë propozoi rendin e ditës si vijojn:

R E N D I I D I T Ë S

1. Miratimi i Raportit kuartal për realizim të Buxhetit të Komunës së Kërçovës për kuartalin e 3 për periudhën, 01.01.2024- 31.09.2024.

2. Propozim Vendim për ndryshim të shpërndarjes së mjeteve në Buxhetin e Komunes së Kërçovës për vitin 2024.

3. Propozim Plan zhvillimorë të Programit për Zhvillim për efikasitet energjetik.

4. Propozim Plan zhvillimorë të Programit për Zhvillim për Shpenzime Kapitale për parqe dhe gjelbërim.

5. Propozim Plan zhvillimorë të Programit për Zhvillim për Sport dhe rekreim.

6. Propozim Plan zhvillimorë të Programit për Zhvillim për rregullimin e tokës ndërtimorendërtim dhe rekonstruim të trotuareve.

7. Propozim Vendim Për huamarrje vendore afatgjate të Komunës së Kërçovës në korniza të Proekt për efikasitet energjetik në sektorin publik (PSEEP)

8. Propozim rregullore për metodologjinë e përcaktimit të kriterëve për ndarjen e blok dotacioneve të destinuara për shkollat fillore të komunës në rajonin e Komunës së Kërçovës.

9. Propozim rregullorje për metodologjinë e përcaktimit të kriterëve për ndarjen e blok dotacioneve të destinuara për shkollat e mesme të komunës në rajonin e Komunës së Kërçovës.

10. Propozim Vendim për ndryshimin e Rregullores për llogaritjen e pagave për nënpunësit publikë në Komunën e Kërçovës

11. Raportit i të ardhurave dhe shpenzimeve për Kuartalin e 3 për rezultatin e arritur financiar të NP Komunalec -Kërçovë.

12. Propotim Programi për punën e I.K Univerziteti i Punëtorëve Krste Misirkov – Kërçovë për vitin 2025.

13. Të ndryshime.

Kryetari i këshillit hapi diskutim dhe fjalën e mori:

Valentina Lazarevska- Përshëndeti të pranishmit dhe informoi se ka vërejtje lidhur me materialet e dorëzuara për pikat 2, 4, 5, 6 dhe 7 të rendit të ditës, sepse të dhënat ishin të ndryshme në pjesën maqedonase dhe atë shqipe. Në pjesën maqedonase dhe shqipe në pikën 2 të rendit të ditës kishte të dhëna të ndryshme në numra dhe për këtë dha disa shembuj. Ajo theksoi se në materialet e dorëzuara kishte shumë mangësi. Në pikat e tjera të rendit të ditës në planet e zhvillimit të programeve, të dhënat nuk përputhen dhe këshilltarët nuk dinin se çfarë ishte e saktë dhe çfarë jo. Ata ishin në konfuzion dhe pyeti nëse duhej bërë korigjim në lidhje me këtë.

Burim Kadriu - Informon se në pikën e dytë në renditjen e mjeteve ka pasur një lëshim nga ana e tyre dhe për këtë do të informojë me sqarimin e pikës.

Valentina Lazarevska - Ajo pyeti nëse kjo do të vlejë edhe për pikat tjera.

Kryetari i këshillit - Informon se kjo do të vlejë edhe për pikat e tjera.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim rendin e ditës së propozuar për këtë seancë me pikën plotësuese dhe u miratua me 16 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

1. PIKA E PARË: Miratimi i Raportit kuartal për realizim të Buxhetit të Komunës së Kërçovës për kuartalin e 3 për periudhën, 01.01.2024- 31.09.2024.

Burim Kadriu – Informon se deri në kuartalin e tretë ka pasur realizim prej 67.8%, kurse vitin e kaluar në të njëjtën periudhë ka pasur realizim prej 68.9% dhe se këtë vit ka pasur realizim më të ulët. Në rastin e taksave ka pasur një realizim më të madh në pjesën e të ardhurave. Në kuartalin e tretë, krahasuar me vitin e kaluar, të ardhurat kapitale kanë pasur rritje prej 35% të realizimit. Gjithashtu, sa i përket shpenzimeve, realizimi ka qenë 65.41% dhe është rritur me 12% nga viti i kaluar. Për pagat dhe kontributet nga pagat 76% realizim ose 12% më shumë se vitin e kaluar, për mallrat

dhe shërbimet 46% dhe ka pasur rënie në krahasim me vitin e kaluar. Detyrimet dhe borxhi i komunës deri në 30 ditë ishin për 1 milion më të mëdha krahasuar me vitin e kaluar. Borxhi total i komunës krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar është ulur me 20 milionë, etj.

Igor Stojanoski - Ai informon se edhe raporti i fundit ka qenë i detajuar dhe i punuar mirë, por ka pasur vërejtje teknike për të dhënat për numrin e popullsisë në Kërçovë, në vend të 56 mijë e 725 banorëve, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2021. dhe të dhënat nga Enti Shtetëror i Statistikave kanë treguar se në Kërçovë ka 39 mijë e 669 banorë dhe kjo është dashur të korrigohet.

Burim Kadriu- Bën me dije se e di që janë 39 mijë, por aty qëndron edhe 56 mijë nga të cilët 39 mijë banorë ishin rezidentë, ndërsa pjesa tjetër jorezidentë. Regjistrimi nuk ka përcaktuar nëse dikush është rezident apo jo dhe konsideron se jemi 56 mijë e 725 banorë.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Miratimi i Raportit kuartal për realizim të Buxhetit të Komunës së Kërçovës për kuartalin e 3 për periudhën, 01.01.2024-31.09.2024 dhe u miratua me 16 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 5 vota PËRMBAJTUR.

2. PIKA E DYTË: Propozim Vendim për ndryshim të shpërndarjes së mjeteve në Buxhetin e Komunes së Kërçovës për vitin 2024.

Burim Kadriu - Ai ka kërkuar falje për dallimet në pjesën maqedonase dhe shqipe të Vendimit për ndryshimin e mjeteve dhe bën të ditur se është papërgjegjësi e tyre. Më pas ai theksoi se pagat në arsim është dashur të rriten me 5%, Ministria e Arsimit duhet ta lokalizojë, por ka pasur vonesë në dorëzimin e të dhënave të faturimit dhe për shkak të nxitimit për ta bërë këtë nuk kanë arritur ta bëjnë siç duhet . Ai informon se në programin AO ka pasur 36 milionë denarë në pjesën shqipe, dhe 48 milionë denarë në pjesën maqedonase. Saktësisht ishte 48 milionë denarë. Më pas, ai përmendi shembuj të tjerë të tillë në programet ku kishte gabime në të dyja pjesët. Ai theksoi se në rastin e vendimeve gjyqësore me përmbarrim ka pasur nevojë për mjete shitesë dhe në shkollat e mesme për paga dhe kontribute.

Valentina Lazarevska - Ajo informon se nuk e ka kuptuar pse G1 ZHEL kishte shërbime për të cilat në pjesën maqedonase ishin paraparë 44 mijë denarë, ndërsa në pjesën shqipe 400 mijë denarë.

Burim Kadriu- Informon se duhet të jetë 44 mijë e jo 400 mijë.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për ndryshim të shpërndarjes së mjeteve në Buxhetin e Komunes së Kërçovës për vitin 2024 dhe u miratua me 16 vota PËR, KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR.

3. PIKA E TRETË: Propozim Plan Zhvillimor për Programin për Zhvillimin e rrugëve lokale dhe rrugicave

Burim Kadriu – Informon se bëhet fjalë për një Plan për rikonstruimin e rrugëve dhe rrugicave lokale i cili është trevjeçar dhe për vitin 2025 ka 16 milionë, për vitin 2026 – 25 milionë dhe për vitin 2027 – 37 milionë shpenzime. Më pas ai ka treguar se ku janë planifikuar të ndërtohen rrugë dhe rrugicat lokale.

Kryetari i këshillit e vuri për miratim Propozim Plan Zhvillimor për Programin për Zhvillimin e rrugëve lokale dhe rrugicave dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

4. PIKA E KATËRT: Propozim Plan zhvillimorë të Programit për Zhvillim për efikasitet energjetik

Burim Kadriu - Informon se komuna e kishte krijuar një program të tillë tashmë për disa vite, për panele fotovoltaike në objektet publike në shkollat fillore dhe të mesme. Ai theksoi se projekti do të vazhdojë edhe më tutje në mënyrë që panele të tilla të vendosen edhe në shkolla të tjera. Për 2025, 2026 dhe 2027 , për çdo vit ishin planifikuar 6 milionë shpenzime.

Valentina Lazarevska – Ajo kërkoi që edhe këtu të bëhet korigjim në indikatorët në pjesën maqedonase dhe atë shqipe dhe në vlerën totale. Në pjesën maqedonase ishte 18 mijë denarë, ndërsa në atë shqipe 24 milionë denarë dhe kërkoi korigjim edhe në të hyra edhe në shpenzime. Gjithashtu ajo kërkoi që në të ardhmen para se t'u dorëzohen materialet për seancën, të kontrollohen paraprakisht mirë, që të mos ketë gabime.

Burim Kadriu- Bën me dije se vlera në tre vjet ka qenë 6 milionë. Në pjesën shqipe ishte 24 milionë, sepse përfshihej edhe viti 2024, ndërsa ishte një vazhdim i vitit 2024.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Plan zhvillimorë të Programit për Zhvillim për efikasitet energjetik dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

5. PIKA E PESTË: Propozim Plan zhvillimorë të Programit për Zhvillim për Shpenzime Kapitale për parqe dhe gjelbërim

Burim Kadriu- Informon se është një parashikim trevjeçar për rregullimin e hapësirave publike dhe ishte planifikuar që të rregullohej te “Sande Shterjoski”, pastaj afër komunës në komandë te ish- ANJ-së të rregullohet parku për të rritur, dhe rregullimi i sipërfaqes tek “Drita” dhe “Mirko Mileski”, e po ashtu edhe në internat. Ai theksoi se janë planifikuar 55 milionë denarë shpenzime për vitin 2025 dhe ka pasur lëshim te indikatorët dhe është dashur të jetë 15 milionë në vitin 2025, 2026. - 25 milionë dhe 2027 - 15 milionë. Te shpenzimet duhet të ishin ndryshuar sipas viteve.

Valentina Lazarevska – Informon se edhe vlera totale në pjesën maqedonase duhej të ndryshohet.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Plan zhvillimorë të Programit për Zhvillim për Shpenzime Kapitale për parqe dhe gjelbërim dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë).

6. PIKA E GJASHTË: Propozim Plan zhvillimorë të Programit për Zhvillim për Sport dhe rekreim.

Burim Kadriu – Informon se po vazhdon ndërtimi i parqeve për fëmijë, parku te “Llamellat” ishte në përfundim, parku tek rrethrotullimi te EVN po ashtu do të përfundojë në vitin 2025 prej 2 milionë e 500 mijë denarë dhe ai projekt do të vazhdojë edhe në vitin 2026 dhe 2027.

Abdulla Sejdini - Ai kërkoi të diskutohet për pikën, ata folën për parqet, dhe duhej të diskutohet për sport.

Burim Kadriu- Informon se për këtë ka deklaruar më herët, kështu që ka vazhduar me parqet.

Abdulla Sejdini - Ai ka kërkuar që në procesverbal të theksohet se këtu bëhet fjalë për sport, ndërsa po diskutohet për parqet dhe ato shifra kanë qenë për këtë.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Plan zhvillimorë të Programit për Zhvillim për Sport dhe rekreim dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

7. PIKA E SHTATË: Propozim Plan zhvillimorë të Programit për Zhvillim për rregullimin e tokës ndërtimorëndërtim dhe rekonstruim të trotuareve.

Burim Kadriu- Informon se vazhdon realizimi në sigurinë e rregullimit të rrugëve dhe rrugicave, për vendkalimet e këmbësorëve dhe rikonstruimin e trotuareve për 3 vitet e ardhshme, dhe për atë janë planifikuar 15 milionë për vitin 2025, 2026- 6 milionë dhe për vitin 2027 - 15 milionë denarë.

Valentina Lazarevska - Informon se është dashur të bëhet korrigjim këtu në vlerën totale, por edhe në shpenzimet, si në pjesën maqedonase ashtu edhe në atë shqipe.

Kryetari i këshillit vendosi për miratim Propozim Plan zhvillimorë të Programit për Zhvillim për rregullimin e tokës ndërtimorëndërtim dhe rekonstruim të trotuareve dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit dha një pushim prej 10 minutash. Pas pushimit seanca vazhdoi.

8. PIKA E TETË: Propozim Vendim Për huamarrje vendore afatgjate të Komunës së Kërçovës në korniza të Proekt për efikasitet energjetik në sektorin publik (PSEEP)

Burim Kadriu –Informoi se bëhet fjalë për huamarrje përmes Ministrisë së Financave, përmes Bankës Botërore, në të cilin projekt ishte përfshirë edhe komuna. Bëhej fjalë për shkolla dhe për ndryshimin e dritareve, ngrohjes, fasadave etj. Në projekt u përfshinë 4 shkolla, përkatësisht: SHF "Sande Shterjoski", SHF "DR-Vladimir Polezhinoski", SHF "Regjë Rushit" dhe SHF "Kuzman Josifoski-Pitu". Prej tyre SHF "Sande Sterjoski" ka marrë 16 milionë, dhe SHF "DR-Vladimir

Polezhinoski" ka marrë 21 milionë denarë, ndërsa SHF "Kuzman Josifoski-Pitu" dhe SHF "Regjë Rushit" nuk janë pranuar, për shkak të periudhës së gjatë të investimit. Bëhej fjalë për 15 vjet, ndërsa ata ishin mbi 15 vjeç. Banka Botërore financoi 80% dhe 20% ishte grant dhe pritej të paguhej në 6 vjet.

Bojan Stojkoski - Ai pyeti pse nuk është pranuar projekti i SHF, "Kuzman Josifoski - Pitu".

Burim Kadriu- Informon se në atë projekt, sipas analizave për financimin e kriterëve të projektit të Bankës Botërore, koha e investimit duhet të jetë më e shkurtër. Atje bëhej fjalë për mbi 15 vjet dhe për këtë arsye nuk u pranuan. Ai ka theksuar se në atë projekt nuk janë përfshirë, por mund të përfshihen në një mënyrë tjetër dhe në projekte të tjera.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim Për huamarrje vendore afatgjate të Komunës së Kërçovës në korniza të Proekt për efikasitet energjetik në sektorin publik (PSEEP) dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

9. PIKA E NËNTË: Propozim rregullore për metodologjinë e përcaktimit të kriterëve për ndarjen e blok dotacioneve të destinuara për shkollat fillore të komunës në rajonin e Komunës së Kërçovës.

Bujar Veseli- bën me dije se Rregullorja për bllok dotacionet për shkollat fillore dhe të mesme ka qenë e njëjtë me atë të vitit të kaluar. Ai theksoi se nga shuma totale e bllok dotacioneve janë zbritur për paga dhe për kosto të tjera operative etj. Ndër kriteret për bllok dotacionet për shkollat fillore ishin: numri i përgjithshëm i nxënësve, puna me turne, kujdesi ditor, persona me nevoja të veçanta etj.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim rregullore për metodologjinë e përcaktimit të kriterëve për ndarjen e blok dotacioneve të destinuara për shkollat fillore të komunës në rajonin e Komunës së Kërçovës dhe u miratua me 22 vota PËR KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

10. PIKA E DHJETË: Propozim rregullorje për metodologjinë e përcaktimit të kriterëve për ndarjen e blok dotacioneve të destinuara për shkollat e mesme të komunës në rajonin e Komunës së Kërçovës.

Bujar Veseli – Informon se edhe këtu ka qenë njëjtë, me faktin se ka pasur ndryshim të kriterëve. Ndër kriteret ishin: numri i përgjithshëm i nxënësëve, numri i nxënësve që përdorin transport etj.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim rregulloren për metodologjinë e përcaktimit të kriterëve për ndarjen e blok dotacioneve të destinuara për shkollat e mesme të komunës në rajonin e Komunës së Kërçovës dhe u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

11. PIKA E NJËMBËDHJETË: Propozim Vendim për ndryshimin e Rregullores për llogaritjen e pagave për nënpunësit publikë në Komunën e Kërçovës

Sekretari i Komunës –Informon se nëse miratohet ky vendim, nëpunësit publik ato të cilët janë të punësiaur sipas LMP do t’ju rriten rrogat dhe do t’ju afrohen rrogave të nëpunësëve administrativ.

Kryetari i këshillit e vuri për miratim Propozim Vendim për ndryshimin e Rregullores për llogaritjen e pagave për nënpunësit publikë në Komunën e Kërçovës dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit informoi se përfaqësuesi i “Komunalecit” nuk ka ardhur ende dhe për këtë ka propozuar që të debatohet për pikën e 13-të të rendit të ditës, në vend të pikës së 12-të sepse përfaqësuesi për pikën e 13-të është këtu. Kështu që, ai hapi debat mbi:

13. PIKA E TREMBËDHJETË: Propotim Programi për punën e I.K Univerziteti i Punëtorëve Krste Misirkov – Kërçovë për vitin 2025.

Drejtori i Universitetit të Punës, “Krste Misirkov” – informon se këtë vit institucioni do të punojë edhe në plan kulturor dhe arsimor. Në planin arsimor u organizuan kurse të jashtëzakonshme ndërsa u kujdesën edhe për kulturat dhe zanatet dhe zhvillimin e multikulturalizmit në vendin tonë.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propotim Programi për punën e I.K Univerziteti i Punëtorëve Krste Misirkov – Kërçovë për vitin 2025 dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

KaloHET në pikën e 12-të të rendit të ditës.

12. PIKA E DYMBËDHJETË: Raportit i të ardhurave dhe shpenzimeve për Kuartalin e 3 për rezultatin e arritur financiar të NP Komunalec -Kërçovë.

Përfaqësuesi nga NP "Komunalec" kërkoi falje për vonesën dhe njoftoi se ndërmarrja deri në kuartalin e tretë kishte 144 milionë të hyra dhe 145 milionë shpenzime. Ata ishin në humbje, por shpresonin se deri në fund të vitit rezultatet do të përmirësoheshin. Ai theksoi se aktiviteti kryesor i ndërmarrje është furnizimi me ujë dhe grumbullimi i mbeturinave dhe këtu të ardhurat kanë qenë më të ulëta, ndërsa shpenzimet janë më të lartat për pagat e punonjësve.

Valentina Lazarevska - Ajo e falënderoi ndërmarrjen që u doli në ndihmë lagjes "Ivanidoll" dhe theksoi se tani është dashur të intervenohet në rrugën "Uzhiçka". Informon se punë qartë është parashtruar në kuartale dhe borxhet që i ka ndërmarrja dhe ndalesat gjyqësore. Ajo pyeti se a ka ndonjë mënyrë për ta zgjidhur atë problem nga komuna si themeluese. A është dashur të zgjidhet nga buxheti i ri apo duhet kërkuar ndihma e Qeverisë dhe a është diskutuar me ato për këtë punë. A kishte një plan dhe strategji për këtë?

Përfaqësuesi nga NP "Komunalec" - informoi se çdo mbështetje është e mirëseardhur pavarësisht se nga është ajo dhe të gjithë së bashku duhet ta kalojnë këtë situatë. Ai propozoi së bashku me këshillin t'i drejtohen themeluesit dhe Qeverisë për ta zgjidhur atë.

Valentina Lazarevska - Informon se në rrugën „Uzhiçka,, para 2 vitesh, NP "Komunalec" ka ndërruar gypat e ujit dhe rruga është ende e gërmuar dhe nuk është bërë asgjë për këtë.

Përfaqësuesi nga NP "Komunalec" - bën të ditur se vjen nga Sektori i Financave dhe nuk ka mundur të përgjigjet për momentin për këtë, por do t'ua kalojë autoriteteve në ndërmarrje, që të zgjidhet.

Bojan Stojkoski - Ai pyeti nëse punëtorët e ndërmarrjes do të marrin K-15, pasi që ndërmarrja është në humbje.

Përfaqësuesi nga NP "Komunalec" - informoi se është obligim ligjor për të gjithë, përfshirë edhe ndërmarrjen e tyre, dhe shpreson që edhe ata të veprojnë brenda kornizës ligjore. Por nuk ishte ai që do ta japë përgjigjen përfundimtare.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Raportit i të ardhurave dhe shpenzimeve për Kuartalin e 3 për rezultatin e arritur financiar të NP Komunalec -Kërçovë dhe u miratua me 15 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR.

Këshilltari Mihajlo Daniloski është liruar nga votimi, sepse është i punësuar në ndërmarrjen.

14. PIKA E KATËRMBËDHJETË: Të ndryshme

Kryetari i këshillit i lexoi kërkesat e parashtruara:

1. Kërkesë nga Jovan Cvetanoski për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në vendbanimin “Ivanidoll 1” dhe atë duke ndërlidhur rrugët e ndërtuara më parë. Si dhe një kërkesë për shpronësimin e një pjese të parcelave që janë në pronësi private.

Kryetari i këshillit sugjeroi që kërkesa t'i dorëzohet organeve kompetente.

2. Kërkesa nga BL Vidrani për përmirësimin e infrastrukturës rrugore duke ndërtuar një rrugë lokale 70 metra të gjatë në tokë shtetërore, për gypa furnizimi me ujë për fshatin në gjatësi prej 70 metra, dhe kyqjen e tre ndërtesave të banimit në sistemin e furnizimit me ujë, si dhe një kërkesë për vendosjen e një muri mbajtës 37 metra.

Kryetari i këshillit bën me dije se kërkesa do t'i kalojë Sektorit për Veprimtari Komunale.

Valentina Lazarevska - Informon se është dorëzuar kërkesë nga BL e Drugovës më 12.07.2024. për pastrimin e rrugës “Goce Dellçev”, gjegjësisht rrugës nga varrezat e qytetit deri në fshat, bëhet fjalë për 500 metra.

Kryetari i këshillit bën me dije se kërkesa do t'i dërgohet Sektorit për Veprimtari Komunale.

Pasi që askush nuk e morri fjalën, dhe me këtë rendi i ditës u shterë për këtë seancë, Kryetari i këshillit e mbylli seancën në ora 12:00 .

Procesverbalist

-Lençe Srbinoska

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Kryetar

Skender Xhabiri d.v.

Përkthyes:Tefik Asani